

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ

E HËNË 8 NËNTOR 2021

Zonja Kryetare,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Kryeministri na mbajti gjysmë ore leksion se çfarë është Eurobondi, për çfarë shërben Eurobondi dhe na tha në fillim se Eurobondi nuk është borxh. Tani ai iku, por puna është se duhet të ketë parasysh ca gjëra. Për shembull, duhet të ketë parasysh se i pari Eurobond i emetuar nga Republika e Shqipërisë është emetuar nga qeverisja e Partisë Demokratike. Kur ne e dinim çfarë ishte Eurobondi, për çfarë shërbente Eurobondi e për çfarë përdorej Eurobondi, një nga ish-ministrat e tij të Financave na akuzonte se po dilnim në tregun evropian për të prishur tregun shqiptar. Si tha? Eurobondi nuk është borxh, por është financim me likuiditet i vetë borxhit. Është mirë që dikush nga ju t'i thotë se edhe kjo gjëja është borxh. Kur ti shkon dhe i merr tjetrit borxh, ia merr në Europë apo ia merr në Shqipëri, i thoni se është borxh. Njësoj është. Pastaj, për pjesën ku na shpjegoi se si, kur një shtëpi ka halle, del e merr borxh, nëse s'ka para, ashtu është në fakt, sepse të gjithë ne, kur s'kemi para në shtëpi, dalim e marrim borxh, por këtë borxh e përdorim për të mbyllur hallet, jo për të blerë televizor apo për të blerë Ferrari, natyrisht as për të ngritur satelitë sipër, sepse ky është shpërdorim i çdo gjëje që ka të bëjë me borxhin dhe me financat e shqiptarëve. U mor gjerë e gjatë me borxhin që qeverisja e Partisë Demokratike ka lënë.

Ajo çfarë ne kemi bërë, është që e kemi lënë borxhin në nivelin 62,5 %. U mblodhët e thatë se janë borxhe që nuk janë të futura në bilanc dhe e çuat në 70%. Dakord. Pastaj, nga ato nuk paguat disa, sepse doli që ishin të tepërta, por sidoqoftë e pranojmë atë standard. Ishte hera e parë që vendosët, dhe e pranojmë atë standard, si të thoni ju. Po mirë, po me veten tuaj, a e aplikoni po këtë standard? Ato borxhet e kontigjencës nuk i fusni brenda? Ato borxhet që janë të rrezikshme për buxhetin e shtetit, siç vijnë detyrim nga koncesioni, nuk i fusni brenda te borxhi? Në qoftë se do të përdoret i njëjti standard, rrezik se sot do të jetë 100 %. Na thoni pastaj që përdorni gjithmonë shprehjen që kanë kaluar dy kriza: tërmeti dhe pandemia. Besoj se për herë të parë, Shqipëria dhe bota kanë pasur krizë sa herë që keni ardhur ju. Përpara nuk ka pasur krizë. Përpara ka qenë jetë shumë e lumtur. S'ju kujtohet kriza financiare e 2008-ës? Nuk ekzistonte, sepse ishte vetëm këtu, apo ishte e përbotshme? Çfarë bënin qeveritë në atë kohë? Nuk bënin gjërat që bëjnë sot, apo jo? Po mirë, more, gjithë ky borxh që morët, të cilin e justifikoni me pandeminë, si ka mundësi që keni dhënë mbështetjen më të vogël për qytetarët shqiptarë, si paketë anti-Covid? Është e vërtetë që ne kemi marrë borxh, por shqiptarëve ua kemi lënë Shqipërinë plot me rrugë. U kemi lënë shqiptarëve investime. U kemi lënë shqiptarëve shkolla e ujësjellës.

Pavarësisht se ju do të thoni që vetëm në kohën tuaj për herë të parë energjia ishte pa ndërprerje, në fakt, që nga 2006-a, shqiptarët kanë harruar ç'është ndërprerja e energjisë elektrike. Të gjitha janë bërë, zoti Braçe, në qoftë se e kundërshton edhe këtë, unë nuk di çfarë quhet fakt dhe çfarë nuk quhet fakt. Doli pastaj e tha: çfarë ka këtu të jashtëzakonshme? Kemi sjellë një akt normativ dhe ne e kemi planifikuar shumë mirë. Epo, në qoftë se e keni planifikuar mirë, çfarë nevojë ka që sillni akt normativ? Akti normativ është në nevojat e emergjencës. Çfarë nevojë paska, kur e keni planifikuar mirë në buxhetin e shtetit? Unë di t'ju them se ne mund të kemi bërë gabimet tona, pa dyshim që po, por çdo qindarkë që është marrë borxh, nuk është shfrytëzuar për gjë tjetër veçse për investime kapitale në Republikën e Shqipërisë. Akuza sipas së cilës, ne me borxhin keqpërdorim financat publike, duke pasur parasysh se kjo qeverisje, në tetë vjet nuk mund të numërojë një investim të qenësishëm, është

diçka e pamoralshme dhe nuk i takon një Kryeministri, i cili nuk ka për të bërë një bilanc të investimeve publike. Ju faleminderit!